



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1995 Prot.
17

Tiranë, më 19.7. 2021

URDHËR

Nr. 233, Datë 19.7-2021

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 199, DATË 03.07.2020, “PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË “SHKENCA POLITIKE/MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE”, ME PROFIL “POLITIKA DHE LEGJISLACIONI NË BASHKIMIN EVROPIAN”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Titulli dhe pika 1 e urdhrin nr. 199, datë 03.07.2020, të ndryshojë si më poshtë:

“Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me profile “Marrëdhënie Ndërkombëtare” dhe “Politikat dhe Legjislacioni i Bashkimit Evropian”, në Universitetin e New York-ut, Tiranë”.

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me profil “Politika dhe Legjislacioni në Bashkimin Evropian”, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me profile “Marrëdhënie Ndërkombëtare” dhe “Politikat dhe Legjislacioni i Bashkimit Evropian”, me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë në Universitetin e New York-ut, Tiranë.

Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me profile “Marrëdhënie Ndërkombëtare” dhe “Politikat dhe Legjislacioni i Bashkimit Evropian” në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.”.

2. Pika 2 e urdhrit nr. 199, datë 03.07.2020 të ndryshojë si më poshtë:

“Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me profile “Marrëdhënie Ndërkombëtare” dhe “Politikat dhe Legjislacioni i Bashkimit Evropian”, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.”.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut, Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

